

Përmbledhje ekzekutive: Raport tremujor nr. 5 për ndjekjen e punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) Arritje në periudhën tetor-dhjetor 2017

Në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), është institucion i mëvetësishëm dhe i pavarur kundër korrupsionit. Qytetarët, si taksapagues, duhet të jenë mirë të informuar se a i përmbush dhe si i përmbush KSHPK obligimet e veta ligjore, sepse nëpërmjet buxhetit të Republikës së Maqedonisë i siguron mjetet për realizimin e kompetencave të KSHPK për parandalimin e korrupsionit.

Nga gjithsej 28 indikatorë të ndjekur në periudhën e raportimit, për të cilët ndiqet përmbushja e obligimeve ligjore ("ngjyrosja e indikatorëve"), 11 përmbushen në tërësi në pajtim me ligjin, 14 përmbushen pjesërisht, ndërsa 4 nuk përmbushen fare.

Krahas bashkëpunimit të vendosur për nevojat e projektit, KSHPK nuk dorëzoi të dhëna për këtë tremujor.

Zgjedhjet lokale tanimë nuk janë në fokus në këtë periudhë raportuese, por mbetet nevojat e hartimit dhe dorëzimit të një raporti të posaçëm për keqpërdorime eventuale gjatë zgjedhjeve lokale të mbajtura në tetor 2017. Në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, KSHPK më së voni në afat prej tre muajve nga përfundimi i zgjedhjeve, ka për obligim t'i dorëzojë një raport të posaçëm Kuvendit të Republikës së Maqedonisë për keqpërdorimet e mundshme gjatë zgjedhjeve – afati është deri në fund të marsit 2018.

Kontroll kundër korrupsionit në legjislaturë (KKL) është duke u realizuar, por jo në tërësi. KSHPK ka bërë katër KKL për pesë ligje të tremujorit të parë, një ligj nga tremujori i dytë dhe një nga tremujori i katërt. KSHPK nuk e ndjek në tërësi planin dhe dinamikën për KKL të ligjeve tanimë të sjellë. Qeveria në këtë periudhë raportuese ka përcaktuar 48 propozim-ligje në seancë, të cilët duhet t'ua dorëzojë KSHPK për kontroll të detyrueshëm për rreziqet nga korrupsioni. Nuk ka informata se a i ka dorëzuar Qeveria deri te KSHPK propozim-ligjet dhe KSHPK a ka bërë KKL.

Nevojitet një ridizajnim i Regjistrit të personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe një mekanizëm për ndjekjen e obligimeve të pakryera nga ana e institucioneve. Në bazë të të dhënave të publikuara në Gazetën Zyrtare, janë emëruar 326 persona në funksion. Nga këta, për 258 (79,14%) persona nuk janë publikuar informata as në Regjistrin e personave të zgjedhur dhe të emëruar, as në bazën për gjendjen pronësore. Praktika e deritanishme tregon se KSHPK nuk e shfrytëzon mandatin e dhënë për nxitjen dhe ngritjen e procedurës për sanksione ndaj institucioneve të cilat nuk i përmbushin obligimet. Prandaj, nevojitet që KSHPK të zhvillojë mekanizma për ndjekjen e mospërmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga kompetenca për mbajtjen e Regjistrit të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Gjithashtu, KSHPK duhet të ndërmarrë hapa për mbindërtimin e aplikacionit të regjistrit dhe të sigurojë mundësi për shfrytëzimin e këtyre të dhënave nga ana e personave juridik dhe publik për krijimin e informatave, përmbajtjeve, aplikimeve apo shërbimeve.

KSHPK duhet t'i intensifikojë aktivitetet për instalimin e sistemit për ndjekjen e gjendjes pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar me një pasqyrë historike. Krahas azhurnimit të rregullt të bazës për gjendjen pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar, nevojitet vendosja e lidhjes elektronike mes Regjistrit të personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe bazës së të dhënave nga fletët anketuese dhe të sigurohen të dhëna historike në dispozicion, me të cilën gjë lehtë mund të ndiqen ndryshimet e gjendjes pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar.

KSHPK filloi me aplikimin më aktiv të Ligjit për mbrojtjen e informatorëve dhe të akteve nënligjore. KSHPK nënshkroi Memorandum për Bashkëpunim me *Transparency International* Maqedoni, i cili parasheh bashkëpunim në aktivitetet në përforcimin e aplikimit efikas të Ligjit për mbrojtjen e informatorëve. Gjithashtu, KSHPK hartoi dhe dorëzoi një raport për denoncimet e pranuar nga informatorët për vitin 2016. Megjithatë,

mbetet rekomandimi se KSHPK duhet të jetë më aktiv në ndjekjen dhe aplikimin e Ligjit për mbrojtjen e informatorëve nëpërmjet fushatave të ndryshme, ngjarjeve dhe promovimeve informative për të punuar në ngritjen e vetëdijes dhe diturisë së publikut më të gjerë për përfitimet pozitive nga dhënia e informatave, por edhe inkurajimi për dhënie informatash.

Në bazë të anketës së realizuar në terren, qytetarët konsiderojnë se **KSHPK e mbron interesin individual, jo atë publik**. Edhe pse qytetarët e njohin KSHPK si një institucion i cili jep kontribut në luftën kundër korrupsionit dhe se do të paraqisnin korrupsion në KSHPK, megjithatë më shumë se gjysma prej tyre konsiderojnë se KSHPK me punën e vet e mbron interesin individual, jo atë publik. Lidhur me këtë është edhe mendimi i më shumë se një të tretës së qytetarëve se KSHPK në mënyrë joefektive e kryen punën e vet.

KSHPK punën e vet duhet ta mbështesë në bashkëpunimin me sektorin qytetar dhe me sektorin e organizuar privat, nëpërmjet mbajtjes së rregullt të takimeve të punës me përfaqësues të sektorit qytetar dhe privat, inkuadrimit të tyre në aktivitetet e tij, nëpërmjet ftesës për pjesëmarrje në punëtorë, grupe pune dhe trajnime dhe të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në aktivitetet e organizuara nga organizatat qytetare dhe nga sektori privat.

Si dhe deri më tani, mbetet nevoja që KSHPK ta rrisë **transparencën** nëpërmjet publikimit të informatave në ueb-faqen e vet për të gjitha aktivitetet e ndërmarra, për të gjitha seancat e komisionit, pa përjashtim, si dhe informata për pjesëmarrjen e organizatave në mbledhjet e punës, grupeve punuese, punëtorëve, trajnimeve dhe konferencave.



Deri te raporti mund të arrin nëpërmjet: